



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 22, Datë 25.01.2021

MBI

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 183, DATË 13.11.2020, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 64, pika 2 dhe nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016 si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 13/2 prot., datë 19.01.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155 prot., datë 02.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje me “Njoftimin për Licencim” nr. 62/35 prot., datë 16.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar në këtë aplikim.
- Shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e

dokumentacionit, për arsye se shkresa e ERE-s nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020 (kërkesë e bërë përpara përfundimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s), është dërguar në adresën qendrore të shoqërisë, në Porocan, dhe personi që e ka marrë në dorëzim, duke qenë i infektuar me COVID-19, nuk ia ka dorëzuar në kohë, çka ka bërë që shoqëria të mos ketë kohën e mjaftueshme për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 245, datë 21.12.2020, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo vendimmarrje iu njoftua shoqërisë me shkresën nr. 1155/3 prot., datë 23.12.2020.
- Shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3 prot., datë 06.01.2021, ka bërë me dije se: “përsa i përket aplikimit për licencë për tregtim të energjisë elektrike heqim dorë për momentin”.
- Neni 64, i Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2 parashikon se:
  - *Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.*
  - *Pas tërheqjes së një pale, **organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.***

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi :**

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s 183, datë 13.11.2020, «Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike».
2. Vendimi i bordit të ERE nr. 183, datë 13.11.2020, «Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike»», shfuqizohet.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**